



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jednica Org./Unit	51-02	Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	5192-2/24
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-	Data: Datum: Date:	31.01.25
PRISHTINË / A			No. 1

DATE/A:	13.01.2024
REFERENC-Ë:	24/5192/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Gimi", Sh.p.k., Suharekë, Bazë për prodhimin e Betonit, Shirokë, K. Suharekë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore.

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "GIMI", Sh.p.k., Suharekë me nr. prot. 24/5192/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Shirokë, K. Suharekë

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/5192/MMPHI
Datë: 13.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Gimi" Sh.p.k. me nr.prot. 24/5192/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betoni, Shirokë, K. Suharekë, në gastrën nr.P-72116046-02785-41, zona kadastrale Suharekë.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Sistemi de-pluhurues të jetë funksional;
- 2.3. Shfrytëzimi dhe shkarkimi i ujërave të bëhet ne përputhje me Lejet Ujore;
- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- 2.5. Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqes operacionale;
- 2.6. Të monitorohen emisionet në ajër dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.



- 2.7. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.8. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Gimi" Sh.p.k. Suharekë, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Shirokë, Suharekë, MMPHI konstaton se operatori i lartcekur i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqimin Mjedisor nr.19/2419/1-ZSP/349/19, të lëshuar me datë:27.06.2019;
- Leje për aktivitetet e veçanta për bazën e betonit me Nr. 872/KPMM/2022 të lëshuar me dt. 04.10.2022, me afat të vlefshmërisë deri me 05.09.2027;
- Leje Ujore për shfrytëzim me nr.: 2032-2/22-ZSP-2023, me dt.20.04.2023;
- Leje Ujore për shkarkimin, me nr.: 2031-2/22 - ZSP-2023, me dt.20.04.2023;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izëdin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi t'i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së